



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2018

### V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

#### **“MBI VAZHDIMIN, PLOTËSIMIN DHE FINALIZIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT, PËR ANKESËN NR. 819 PROT., DATË 05.07.2018, DREJTUAR KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”.**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit të Kryetarit të KLSH nr. 819/2 prot., datë 20.11.2018, nga data 21.11.2018 deri më datën 27.11.2018, në subjektin “Spitali Rajonal Durrës”, u krye auditimi tematik “Mbi vazhdimin, plotësimin dhe finalizimin e procesit të verifikimit, për ankesën nr. 819 prot., datë 05.07.2018, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi tematik i ushtruar në Spitali Rajonal Durrës, u konstatuan të meta dhe shkelje me pasoja financiare në drejtim të procedurës së prokurimit me objekt: *“Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”.*

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin e Auditimit Tematik me objekt “Autorizim për verifikim në Spitali Rajonal Durrës” të ushtruar në Spitali Rajonal Durrës, sipas autorizimit të Kryetarit të KLSH nr. 819/2 prot., datë 20.11.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi tematik i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike, lidhjen e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

-Në auditimin tematik të ushtruar, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në auditimin tematik të ushtruar, nga AK janë vendosur kritere diskriminuuese, evazive dhe konfuzë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 46.

-Në auditimin tematik të ushtruar, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO dhe KSHA, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

-Në auditimin tematik të ushtruar, zbatimi i kontratës, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

-Në auditimin tematik të ushtruar, në kundërshtim me nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kushtet kur në këtë raport përmbledhës mungojnë të dhëna kryesore si, referenca e procedurës së prokurimit dhe përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, pasqyrimi i ankesave, etj, titullari i AK, bazuar në dispozitën e sipërcituar nënligjore, në kushtet e mungesës së elementëve thelbësorë të sipërpërmendur, nuk duhej të kishte bërë miratimin e këtij raporti përmbledhës. Për më tepër, në raport përmbledhës janë pasqyruar arsye të ndryshme skualifikimi me sa janë njohur operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit elektronik të APP.

-Në auditimin tematik të ushtruar, procedura nuk ishte e inventarizuar dhe e arkivuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

**Rekomandimi:** Për rritjen e efijencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballeshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, titullari i AK të marrë masa të menjëhershme që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve, pasi në auditimin tematik të ushtruar, vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi tematik i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizimi i shërbimit të lavaxionit për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166,666,500 lekë pa TVSH, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 1905/4 Prot., datë 26.09.2017, me vlerë 171,428,400 lekë me TVSH, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 25,828,545 lekë**, si rezultat i procedurës jo konform ligjit të ndjekur nga AK. Kjo vlerë vjen si rezultat i diferencës së ofertës me vlerë më të ulët të paraqitur, me ofertën e shoqërisë fituese, me të cilën është lidhur edhe kontrata. Në këtë rast, vlerësimi i ofertave pjesëmarrëse është bërë në kundërshtim me nenin 53/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me dokumentet standarte të tenderit, përfshirë kërkesat për kualifikim. Referuar rastit konkret, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësim në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, duke mbajtur dy qëndrime në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, ku për ofertën më të ulët të paraqitur mbahet qëndrimi për skualifikim, ndërkohë për ofertën me vlerë më të lartë, me të cilën është lidhur edhe kontrata, mbahet qëndrimi për kualifikim. Lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar ndaj Buxhetit të Shtetit, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesës, si dhe titullari i AK, në

cilësinë e personit përgjegjës, i cili jo vetëm ka favorizuar shoqërinë fituese duke mos shqyrtuar ankesën për kualifikim të pa drejtë, po edhe për miratimin e raportit përmbledhës në kundërshtim me ligjin, si dhe personit përgjegjës që ka nënshkruar kontratën (theksojmë vetëm me një operator, duke mbajtur dy qëndrime të ndryshme).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës prej 25,828,545 lekë**, shkaktuar si pasojë e vlerësimit të gabuar të ofertave në kundërshtim me neni 53/3 të LPP, përkatësisht nga të gjithë personat përgjegjës.

**Menjëherë**

## **C Masa disiplinore**

**C.1** Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, kërkojmë nga Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin mbi auditimin tematik të ushtruar, për:

### **“Largim nga puna”**

**1. Për Znj. V. C.**, me detyrë ish titullare e AK, aktualisht punonjëse e sektorit të prokurimeve, për arsye se:

- Në këtë procedurë prokurimi ka qenë edhe anëtare e njësisë së prokurimit, ku ka nënshkruar në dokumentet e tenderit, njëkohësisht ka bërë edhe miratimin e raportit përmbledhës, në cilësinë e titullarit të AK.

- Ka vendosur dhe përcaktuar edhe kërkesat për kualifikim, ndërkohë që ka qenë titullar i AK, shkelje flagrante e LPP, pasi ka vendosur për kërkesat për kualifikim me iniciativën e saj, pa patur ankesë në dispozicion, ku për më tepër, ankesës i është kthyer përgjigje nga KSHA, që pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë.

- I ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese “Sh.” Sh.p.k. ndërkohë që ankesa nuk është shqyrtuar e plotë, pasi nuk është marrë në konsideratë pjesa e pretendimeve lidhur me kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik të shpallur fitues nga AK.

- Ka mbajtur dy qëndrime/standarte lidhur me procedurën e ndjekur, pasi ka miratuar një raport përmbledhës, në të cilin janë pasqyruar arsye të ndryshme skualifikimi, për sa është vlerësuar në sistemin e prokurimit elektronik.

- Ka bërë në mënyrë individuale ndryshimin e kërkesave për kualifikim duke marrë për bazë pretendimet e ankuesit, ndërkohë që komisioni i ngritur po prej saj për shqyrtimin e ankesës, ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë, për të cilën ka nënshkruar edhe në kthimin e përgjigjes.

- I ka kthyer përgjigje shoqërive ankuese, sipas të cilave ka konkluduar se nuk merren në konsideratë pretendimet e ngritura, ndërkohë ka bërë modifikimin e kërkesave për kualifikim, ku një kompetencë e tillë nuk është e titullarit të AK.

- Në kushtet e shkeljeve flagrante të ligjit, nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës, i cili është në kundërshtim me LPP.

- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, ka nënshkruar kontratën vetëm me një operator ekonomik, ndërkohë që shoqëria fituese është bashkim operatorësh ekonomikë.

- Ka miratuar një raport përmbledhës, ku është pasqyruar se bashkimi i operatorëve ekonomikë me vlerë më të ulët duhet të skualifikohet, pasi kryesuesi/përfaqësuesi është anëtar i që ka marrë përsipër të realizojë 19.3% të kontratës së bashkëpunimit, ndërkohë që edhe operatori ekonomik fitues, me të cilin është lidhur edhe kontrata nga Znj. V. C.,

përfaqësuesi/kryesuesi ka marrë përsipër të realizojë vetëm 10% sipas kontratës së bashkëpunimit, pra duke mbajtur dy standarte/qëndrime.

- Ka miratuar një raport përmbledhës ku është pasqyruar se bashkimi i operatorëve ekonomikë me vlerë më të ulët duhet të skualifikohet, pasi kryesuesi/përfaqësuesi është vlerësuar se ka bërë bashkim operatorësh ekonomikë fiktiv, pasi kryesuesi ka marrë përsipër të realizojë më pak se 50% sipas kontratës së bashkëpunimit, ndërkohë që edhe operatori ekonomik fitues, me të cilin është lidhur edhe kontrata, ndodhet në të njëjtat kushte, pra duke mbajtur dy standarte/qëndrime.

- Ka miratuar një raport përmbledhës ku është pasqyruar se një nga arsyet e skualifikimit të shoqërisë me vlerë më të ulët është se nuk plotëson kërkesën për kualifikim, pasi kërkohen shërbime të ngjashme deri në 40% të vlerës së fondit limit, ndërkohë duhej ta kishte mbi 40%, arsyetim ky cili nuk gjendet i bazuar në ligj, në kushtet kur kjo kërkesë konfuze plotësohet nga shoqëria, pasi vetë kërkesa e AK ka qenë deri në një vlerë sa 40% e fondit limit.

- Me iniciativën e saj, ka bërë ndryshimin e kërkesave për kualifikim, duke rritur kërkesën për vlerën e xhiros nga 40% në 100% të vlerës së fondit limit, ndërkohë që komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës, ka bërë ndryshimin e kësaj vlere nga 100% në 40% të vlerës së fondit limit, me qëllim rritjen e konkurrencës në prokurim.

- Ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, ndërkohë që në këtë raport mungojnë elementët thelbësore, ashtu sikurse parashikohet në LPP.

- Ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, në të cilin janë pasqyruar arsye të cilat nuk janë dhënë si skualifikim nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, si dhe në raportin përmbledhës nuk janë pasyruar të detajuara ankesat në KPP.

- Gjithashtu, ky person i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese (e cila është edhe shoqëria që ka fituar procedurën e prokurimit) duke i sqaruar që nuk mer në konsideratë asnjë nga pikat e ankesës së trajtuar, ndërkohë që me shkresën nr. 1165/2 prot., datë 13.06.2017, ka marrë në konsideratë të gjitha pikat që shoqëria ankuese (fituesja e tenderit) ka paraqitur në ankesën e bërë.

- Titullari i AK, Znj. V. C., sipas kompetencës që ligji parashikon, ka qenë në dijeni të faktit që *pjesa e ankesës për kualifikim të padrejtë të shoqërisë fituese, nuk është trajtuar nga KSHA*, duke favorizuar në këtë mënyrë shoqërinë fituese, pra pa ngritur asnjë komision për shqyrtimin e pretendimeve të shoqërisë ankuese, për kualifikim të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

**C.2** Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, kërkojmë nga Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, *“Vërejtje”* deri në *“Largim nga puna”*, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin mbi auditimin tematik të ushtruar, për:

**1.** Për **Z. E. Sh.**, me detyrë ish kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave, për arsye se:

- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, ka qenë edhe kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave, ku ka bërë edhe vlerësimin e shoqërive pjesëmarrëse, si dhe në të njëjtën kohë ka bërë edhe miratimin e vlerësimit të bërë prej tij, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit.

- Ka pasqyruar në raportin përmbledhës, arsye të ndryshme skualifikimi, për sa ka bërë vlerësimin në sistemin e prokurimit elektronik.

- Ka mbajtur dy standarte në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, ku si pasojë është skualifikuar oferta më e ulët e paraqitur, si dhe duke kualifikuar si të vlefshme vetëm ofertën e shoqërisë me të cilën është lidhur edhe kontrata, pra duke mbajtur dy standarte/qëndrime.

- Ka bërë vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP.

- Ka kualifikuar një shoqëri, me të cilën është lidhur dhe kontrata, e cila ndodhet në të njëjtat kushte, ashtu sikurse është skualifikuar edhe oferta më e ulët e paraqitur.

- Ka nënshkruar në kthimin e përgjigjes, duke i vënë në dispozicion shoqërisë ankuese edhe një dokument, i cili mban datën disa ditë më vonë se shkresa e dërguar si kthim përgjigje.

- Ka mbajtur dy qëndrime/standarte në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse.

**C3.** Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, kërkojmë nga Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin mbi auditimin tematik të ushtruar:

Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për të gjithë personat e tjerë, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, njësisë së prokurimit dhe komisioneve të shqyrtimit të ankesave, sipas shkeljeve të pasqyruara në këtë vendim, mbi auditimin tematik të ushtruar në Spitali Rajonal Durrës, në varësi të llojit të shkeljes së kryer prej tyre, ku masa disiplinore ndaj anëtarëve të KVO duhet të jetë më e rëndë.

#### **C.4. MASA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Për ish punonjës **Z. A. R.**, në cilësinë e ish titullarit të autoritetit kontraktor, nuk rekomandojmë masë disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, për arsye se personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore do të ishte nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

#### **Shënim**

**Në lidhje gjetjet e mësipërme, ndaj personave përgjegjës është bërë kallëzim penal në institucionin përkatës.**

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**